

IV. PËRFAQËSIMI POLITIK, ZGJEDHJET DHE PARTITË POLITIKE

NOCIONET KRYESORE:

Përfaqësimi demokratik; partia politike; pluralizmi politik; sistemi politik; sistemi dypartiak; sistemi shumë partiak; sistemi pseudopartiak; zgjedhjet; sistemi zgjedhor; e drejta zgjedhore; trupi zgjedhor (elektorati); teknika zgjedhore; kandidimi; njësia zgjedhore; zgjedhjet uninominale (individuale); zgjedhjet plurinominale (sipas listës); shpërndarja e mandateve zgjedhore; metodi i shumicës zgjedhore; modeli proporcional zgjedhor; modeli i përzier zgjedhor; listat zgjedhore; zgjedhjet rregulare; Komisioni zgjedhor shtetëror.

PYETJE :

1. Çka është demokracia përfqësuese ?
2. Çka është partia politike ?
3. Cilat janë elementet konstitutive të partive politike ?
4. Çka është sistemi politik ?
5. Çka është sistemi dypartiak ?
6. Çka është sistemi pseudopartiak ?
7. Kush mund të formojë parti politike në RM ?
8. Çka janë zgjedhjet ?
9. Çka është sistem zgjedhor ?
10. Çka është e drejtë zgjedhore aktive dhe pasive ?
11. Kush e përbën trupin zgjedhor (elektoratin) në RM ?
12. Çka është teknika zgjedhore ?
13. Çka është njësi zgjedhore ?
14. Sqaroni termin zgjedhje uninominale (individuale)!
15. Sqaroni termin zgjedhje plurinominale (sipas listës) !
16. Sipas cilit model mund të bëhet shpërndarja e mandateve ?
17. Sqaroni modelin e shumicës zgjedhore !
18. Sqaroni modelin proporcional zgjedhor ?
19. Çka janë zgjedhjet rregulare ?
20. Cilat organe i zbatojnë zgjedhjet ?
21. Cilat organe janë kompetente për mbrojtjen e të drejtave të subjekteve zgjedhore?

1. Për përfaqësimin demokratik

Përfaqësimi politik d.m.th. qeverisje e popullit nëpërmjet përfaqësuesve, ndërsa jo direkt, qeverisje në emër të popullit dhe për popullin, por jo të vetë popullit.

Përfaqësuesi zgjedhor e paraqet shoqërinë në tërësi, e jo ato të cilët e kanë zgjedhur. Ai është i lirë për vendimin dhe i papërgjegjshëm.

Përfaqësimi politik është formë e përcjelljes së pushtetit nga shumica e përfaqësuesve zgjedhor – nëpërmjet zgjedhjeve të lira në të cilat garojnë partitë politike. Pluralizmi politik në shek. XVII dhe XIX dhe zgjedhjet e lira dhe të singerta e ofrojnë të njëjtën.

Me krijimin e shteteve të mëdha nacionale në të cilat nuk mund të qeveriset nëpërmjet formave të demokracisë direkte, përfaqësimi bëhet domosdoshmëri. Xhon Stjuart Mil është mbrojtës i demokracisë përfaqësuese. Cështja e tij themelore është si të sigurohet qeveria efikase dhe respektimi i të drejtave dhe lirive personale. Zgjedhja gjendet në zgjedhjet e përgjithshme dhe në shtypin e lirë.

Nën ndikimin e teorisë liberale, përfaqësimi demokratik llogaritet për “ formë më të mirë të qeverisjes”. Ajo bazohet në tri shtylla :

- a) përfaqësimi;
- b) zgjedhjet e lira;
- c) të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të qytetarëve.

Megjithatë, në kushte të përfaqësimit demokratik, politika gjithnjë e më pak është *res publica* (punë publike), ndërsa gjithnjë e më shumë veprimtari e rezervuar për elitat partiake.

2. Partitë politike

Demokracia bashkëkohore bazohet në forma të ndryshme të organizimit të qytetarëve. Kuptohet, në formimin e tyre qytetarët udhëhiqen nga interesat konkrete politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të tjera. Duke u lidhur, ato realizojnë ndikim të madh. Pluralizmi i interesave natyrisht kërkon pluralizëm politik, pra shumësi të pyetjeve nga interesi publik. Aleksis de Tokvil do të vërente në “ Demokracia në Amerikë” (1835) “ e drejtë më natyrore e njeriut, përveç të drejtës të veprjës në interes të vetin është e drejtë t’i lidhin interesat e veta me interesat e më të afërmëve dhe të veprjës me to”. Për atë “ e drejta e shoqërimit është e drejtë e patjetërsueshme si edhe e drejtë e lirisë personale”.

Baza kushtetuse e pluralizmit politik janë të drejtat dhe liritë politike, e veçanërisht liria e të folurit dhe liria e shoqërimit politik.

Pluralizmi politik është pjesë e pluralizimit shoqëror. Ai realizohet nëpërmjet formave të ndryshme : partive politike, grupeve të interesave, shoqërimi i qytetarëve, lëvizja politike. Ato janë lidhje, medijatorë, ura në mes të qytetarëve si individë dhe pushtetit.

Qytetarët shoqërohen në parti politike që të marrin pjesë në luftën për pushtet, ndërsa në grupe dhe shoqata të interesave që të ndikojnë dhe i kontrollohen bartësit e pushtetit. Ka dy shekuj, që partitë politike janë instrument i pazavendësueshëm i përfaqësimit demokratik.

Pa to demokracia dhe pluralizmi politik janë vetëm kategori teorike dhe ideologjike.

Etimologjikisht, fjala parti rrjedh nga fjala latine *pars* – pjesë e një tërësie dhe folja *partire* që d.m.th. ndarje ose mbajtje e anës së caktuar. Bëhet fjalë për grup që formohet me ndarjen nga grupi tjetër ose tërësi e cila mban anën e vet, për shkak të së cilës është në konflikt me grupin tjetër.

Partitë politike formohen me paraqitjen e përfaqësues demokratike gjatë shekullit XVIII, e veçanërisht me zgjerimin e të drejtës zgjedhore në shek. XIX. Shkaku? Nevoja për ndërmjetësues në mes të zgjedhësve dhe instituteve përfaqësuese. Për Maks Veber “ partitë janë fëmijë të demokracisë dhe të drejtës së përgjithshme zgjedhore”.

Partia politike është organizim i përhershëm politik i mendimtarëve me ide të njëjta të cilët në mënyrë demokratike luftojnë për pushtet ose , për ndikim në pushtet.

Elementet konstitutive të partive politike janë :

- e para, ajo është formë e përhershme e organizimit politik të qytetarëve;
- e dyta, ka ideologjinë personale të shprehur në program;
- e terta, vepron të tërë territorin shtetëror;
- e katërta, lufton për fitimin e pushtetit me anë të zgjedhjeve të përgjithshme ose . për ndikimin demokratik ndaj saj.

Sistemi partiak është sistem i marrëdhënieve në mes të partive të përhershme në vend, marrëdhënie të bashkëpunimit dhe marrëdhënie e opozitës dhe konfliktit.

Nga aspekti i numrit të partive politike që ndërrohen në pushtet, dallojmë : sistem dypartiak dhe shumëpartiak.

Sistemi dypartiak paraqitet kur dy parti reciprokisht ndërrohen në pushtet në kushte të pranisë së sistemit të shumicës zgjedhore. Në to ekziston disiplinë e fortë partiake me ndihmën e të cilëve sigurohet shumica e sigurtë parlamentare.(psh. Anglia- partia Konzervative dhe Laburiste).

Sistemi pseudopartiak është qeverisje e dy partive më të mëdha , por jo me disiplinë të fortë dhe shumicë të sigurt parlamentare(psh. SHBA - partia Republikane dhe Demokratike).

Sistemi shumëpartiak paraqitet në më shumë forma . Karakterizohet me shumicë të partive në skenën politike, shumicë jostabile parlamentare, kualicion partiak dhe sistem zgjedhor proporcional dhe të përzier.

Logjika e jetës partiake janë frytet e fitores zgjedhore që t'i mbledhë ato më të merituarit për marrjen e pushtetit (*spoils system*) ose sistem i ndarjes së gjahut.

Rreziku nga burokratizmi është i madh, por përvoja dy shekullore e përfaqësimit demokratik nuk ka gjetur zgjidhje më të mirë nga partitë politike dhe nga pluralizmi politik.

2.1. Partitë politike në Republikën e Maqedonisë

Pluralizmi politik është vlerë themelore e rregullimit kushtetues në Republikën e Maqedonisë (neni 8, paragrafi 1,alineja 5). Kushtetuta i përcakton partitë politike si formë të realizimit të saj (neni 20, paragrafi 2).

Ligji për partitë politike është sjellë në vitin 1993. Sipas tij, partitë politike janë grupe të organizuara të qytetarëve të cilët pajtohen për pjesëmarrje në pushtet. Ai parasheh mënyrë mjaft liberale për formimin e partive politike nga ana e 500 qytetarëve të rritur- shtetas të Republikës së Maqedonisë, me vendbanim të përhershëm në të. Partia politike mund të fillojë me punë fill pas regjistrimit ta saj në regjistrin gjyqësor në gjyqin e apelacionit.

Parogrami dhe aktiviteti i partive politike nuk guxojnë të jenë të orientuara në drejtim të shkatërrimit me dhunë të rregullimit kushtetues, nxitjes ose thirrjes në agresion luftarak dhe flakjen e urrejtjes nacionale fetare ose racore dhe pa durueshmërinë (neni20,paragrafi 3 nga Kushtetuta).

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë katërdhjetë parti politike. Disa prej tyre janë të formuara sipas kriterit qytetaro-sociologjik, e të tjerat sipas kriterit etnik dhe fetar.

Është e njohur se skena e partive maqedonase është më dinamike, ndërsa shoqëria e Maqedonisë politikisht është e segmentuar.

Partitë tona ende nuk janë në bazë të thellë socialo-ekonomike.

Në mungesë të traditës, të demokracisë dhe të kulturës demokratike politike, nuk përkujdesen dhe nuk preferojnë dialogun dhe tolerancën. Marrëdhëniet ndërpartiake më shumë janë relacion i armiqëve partiak, se sa partner dhe jomendimtarë të njejtë partiak.

Kuptohet, demokracia , po edhe sistemi politik mësohen me ushtrime.

2. Zgjedhjet

1. Zgjedhjet janë formë universale për artikulumin e pluralizmit politik dhe demokratik, si edhe instrument themelor në secilën shoqëri demokratike për marrjen e pushtetit në mënyrë të qetë.

Ideja për zgjedhjen e atyre që janë në pushtet është e pandashme me teorinë e sovranitetit popullor, si edhe bazë dhe burim i demokracisë indirekte (përfaqësuese).

Duke i rrënuar themelet dhe institutet e shtetit aristokrat dhe të monarkisë absolute, borgjezija duhej të ndryshojë mënyrën e rregullimit të bartësve më të lartë të pushtetit politik, specifike e feudalizmit.

Zgjedhjet janë proces ku populli ua beson kryerjen e pushtetit politik të trupave përfaqësuese, ndërsa në shumë shtete bashkëkohore demokratike dhe kryetari i republikës, të cilët e prezantojnë vullnetin e tyre sovran. Me to dhe në mes tyre pushteti shtetëror fitohet me legjitimitet dhe legalitet.

2. Sistemi zgjedhor është përmbledhje e marrëdhënieve shoqërore, aktiviteteve dhe procesve që linden gjatë zgjedhjes së trupave përfaqësues dhe kryetarit të Republikës që janë të rregulluara me rregulla juridike. Dmth, sistemi zgjedhor është sintezë e elementeve formalo-juridike dhe politiko-sociologjike. Sa është më i madh uniteti në mes këtyre dy kategorive, aq më shumë ky nënsistem i rëndësishëm i sistemit shoqëror, dmth realizim dhe vërtetim i konsenzusit në mes të bartësve të funksioneve të pushtetit dhe përfaqësuesve të tyre.

3. E drejta zgjedhore është e drejtë të zgjedhë përfaqësues (e drejta aktive zgjedhore) dhe të jesh i zgjedhur për përfaqësues nga qytetarët (e drejta pasive zgjedhore).

Nga vitet e njëzeta të shek. XX në shumicën e shteteve e drejta zgjedhore është e përgjithshme, e barabartë direkte dhe e fshehtë (SHBA- 1920, Angli-1992, Francë-1944, Itali-1945, ndërsa në Republikën Jugoafrikane -1992).

Për arritjen e saj kërkohet moshë e caktuar si garanci për pjekuri personale dhe shoqërore të zgjedhësve. Në demokracitë bashkëkohore kjo moshë është nga 18-21 vjet.

4. Trupin zgjedhor (elektorati) të Republikës së Maqedonisë e përbëjnë qytetarët të cilët janë shtetas të Republikës së Maqedonisë dhe kanë 18 vjet si edhe aftësi për punë. (*capacitas agendi*)

Në disa vende e drejta zgjedhore pasive kur bëhet fjalë për funksionet e caktuara (shëf i shtetit, senatori etj.) lidhet ndaj moshës së caktuar. P.sh. e drejta e zgjedhjes pasive për shëf të shtetit në SHBA fitohet me 35 vjet dhe u dedikohet personave të cilët janë të lindur si shtetas të SHBA dhe kanë banuar në SHBA së paku 14 vjet. Gjithashtu, për senator mund të kandidohet vetëm person i cili ka së opaku 30 vjet dhe së paku 9 vjet shtetësi të SHBA, ndërsa për anëtarë të Shtëpisë përfaqësuese kërkohet moshë 25 – vjeçare dhe 7 vjet shtetësi amerikane.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë kërkon moshë 40 –vjeçare për shëf të shtetit dhe banim deri në ditën e zgjedhjeve së paku 10 vjet nga 15 vjetët e fundit.

Ka kushtetuta ku votimi është obligim për qytetarët (Kushtetuta e Belgjikës nga viti 1931, Kushtetuta e Italisë nga viti 1948, Kushtetuta e Greqisë nga viti 1968). Megjithatë, në demokracitë bashkëkohore votimi i domosdodhëm është përjashtim , se sa rregullë. Arsye për trajtimin e të drejtës zgjedhore si funksion publik shtrihet me qëllimin të reduktohet apstenimi i zgjedhësve. Kuptohet, se presioni politik i shprehur nëpërmjet sanksioneve nuk është zgjedhje demokratike. Zgjidhja është në zhvillimin e kulturës participative politike.

4.Në botën bashkëkohore , siç përmendëm, *de jure* e drejta zgjedhore është e barabartë, që dmth vota e secilit zgjedhës , pa marrë parasysh përkatësinë e gjinisë, nivelin e arsimit ose pozitën shoqërore, ka vlerë të njëjtë. Kuptohet, barazia vlen edhe për të drejtën zgjedhore aktive dhe pasive të qytetarëve dhe zgjedhësve të organeve shtetërore përfaqësuese dhe në kandidimin personal të anëtarëve në to.

Sot, megjithatë, jobarazia faktike e të drejtës zgjedhore është realitet. Pra, me hartimin e ndërgegjshëm të njësive zgjedhëse (*Gerymandering*) , sipas madhësisë , njësitë e ndryshme zgjedhore fitojnë numër të njëjtë të përfaqësuesëve. Gjithashtu, është e mundur që njësitë zgjedhoreme numër të njëjtë të zgjedhësve të zgjedhin numër jo të barabartë të përfaqësuesve. Atëherë edhe më gjithë barazinë juridike të së drejtës zgjedhore *de facto* qytetarët kanë të drejtë zgjedhore jo të barabartë në kuptimin politiko-sociologjik.

Zgjedhjet bashkëkohore, kryesisht, janë direkte, që d.m.th., qytetarët direkt e shprehin vullnetin personal, vendin votues, pa asnjë ndërmjetësues në mes tyre dhe përfaqësuesve të tyre.

Zgjedhjet indirekte sot janë rrallësi si formë dhe zgjedhje të rëndësishme të përfaqësuesve nga trupat zgjedhorë të përcaktuar (kolegjiun), ndërsa jo direkt nga qytetarët.¹

Votimi i fshehtë d.m.th. se askush nuk guxon të ndikojë dhe të kontrollojë votuesin gjatë zgjedhjes (as partitë politike, as edhe shteti)². Kuptohet, historia njeh

¹ Senatin e Francës psh. Nuk e zgjedhin direkt qytetarët francez, por kolegiumi special që e përbëjnë këshilltarë gjeneralë dhe regjionalë, deputetë, delegatë të këshillit komunal.

edhe votimin publik (Kushtetuta e Montanjarës nga viti 1783, votimi i anëtarëve të OÇN të gjatë LNÇ).

6. Teknika zgjedhore është shuma e aktiviteteve që merren dhe instrumenteve që zbatohen në procesin zgjedhor për shkak të realizimit të së drejtës zgjedhore.

Kandidimi është fazë initiale i zgjedhjeve. Karakteri i zgjedhjeve në shkallë të lartë varet nga subjekti politik të cilit i është besuar ky funksion , si dhe nga mënyra e realizimit të saj.

Kandidimin, gjegjësisht propozimin e kandidatëve për funksionet zgjedhore, shpesh herë e kryejnë : partitë politike, gjegjësisht udhëheqësitë e tyre (modeli i patronatit ose caucus system); anëtarët e partive (nëpërmjet të konventave partiake) ose simpatizantëve partiakë (nëpërmjet të zgjedhjeve primare). Gjithashtu, edhe qytetarët si kandidat të parvarur mund të jenë bartës të kandidature, nëse janë të përkrahur nga numër i caktuar i qytetarëve.

Kuptohet, nuk ka zgjedhje demokratike në kushte të “vrapimit me një kalë” (one horse race) dhe të një opcioni politik por, vetëm nëse garojnë më tepër kandidatë për një mandat dhe nëse në lojë janë opsione të ndryshme politike

7. Njësia zgjedhore është një pjesë territori shtetëror në të cilën zgjidhen një ose më tepër përfaqësues. Disa herë, dhe gjithë shteti mund të paraqesë një njësi zgjedhore (psh. gjatë aplikacionit të sistemit zgjedhor proporcional). Kriteri themelor gjatë hartimit të njësive zgjedhore është barazia e të drejtës zgjedhore, përafërsisht numër i njëjtë i përfaqësuesish me numër të njëjtë të qytetarëve . Madhësia e numrit të njësive zgjedhore varet nga modeli i ndarjes së mandateve (i shumicës dhe i proporcionalitetit). Dallojmë njësi zgjedhore të mëdha dhe të vogëla. Njësi zgjedhore e vogël është ajo në të cilën zgjidhet një përfaqësues, ndërsa e madhe është ajo në të cilën zgjidhen më tepër përfaqësues në bazë të listave partiake.

8.Zgjedhjet uninominale (*individuale*) janë ato gjatë të cilave zgjidhet një kandidat në suazat e njësive zgjedhore. Numri i njësive zgjedhore është i barabartë me numrin e anëtarëve të trupave zgjedhorë.

Zgjedhjet plurinominale (sipas listës) janë ato ku në një njësi zgjedhore votohet për më shumë kandidatë, gjegjësisht për listë të kandidatëve. Lista mund të mbyllet (bloquee), që dmth zgjedhësit mund të votojnë vetëm për kandidatët e nënvizuar, pa mundësi të shënojnë kandidat të ri.

Lista është e hapur ose e përzier ku ato kanë të drejtë të bëjnë korrigjime nëpërmjet të shtimit të kandidatëve të rinj.

² Për atë edhe votimi zhvillohet në kuti zgjedhore, ndërsa fletëvotimet futen në kuti zgjedhore të mbyllura.

Gjithashtu, dallojmë listë të lëvizëse dhe të palëvizëshme varësisht nga ajo se a kanë qytetarët mundësi të ndryshojnë radhitjen e kandidatëve në listën partiake, ose, jo.

9. Shpërndarja e mandateve zgjedhore është akt përfundimtar në procesin e zgjedhjes së anëtarëve të trupave përfaqësues dhe segment kryesor në sistemin zgjedhor. Sistemet politike zgjedhore, kryesisht, zbatojnë dy metoda të zgjedhjeve: të shumicës dhe proporcionale, ndërsa disa herë të dy kombinohen në të a.q. modeli zgjedhor i përzier.

Sipas modelit zgjedhor të përzier, me të drejtë mandati (vend deputeti) fiton kandidati i cili ka fituar më shumë vota nga zgjedhësit (e kektorati), qoftë të ketë fituar edhe një votë më shumë se gjysma e zgjedhësve (shumica absolute) ose më shumë vota nga kandidatët e tjerë (shumicë relative ose a.q. *FPTP system – first past the post system*).

Modeli i shumicës zgjedhore në të dy variantet parimisht mund të zbatohet edhe në njësi më të vogla dhe të mëdha zgjedhore. Në realitet, ky model zbatohet vetëm në njësitë e vogla zgjedhore. Sa më shumë që është e madhe njësi zgjedhore (e madhe është atëherë ku në të zgjidhen më shumë kandidatë), më i madh është joproporcionaliteti në mes numrit të votave të fituara dhe mandateve të fituara. Sot ky model zbatohet në Angli, SHBA, Kanada (në variantin e shumicës zgjedhore).

Sipas modelit proporcional (reciprokisht) përfaqësimi, mandati i trupave përfaqësues ndahet sipas votave të fituara, gjegjësisht secila parti është e prezentuar nga trupi përfaqësues proporcionalisht me numrin e votave të zgjedhësve.

Ky model mund të zbatohet vetëm në njësitë e mëdha zgjedhore (ato në të cilat zgjidhen më shumë përfaqësues). Ekzistojnë dhjetra variante të modelit proporcional zgjedhor: modeli zgjedhor me herës, modeli i D'Hondt-it, Single transferable vote, modeli i Hagenbach-Bischoffit (Hegenbach-Bischoff) dhe etj. Modeli proporcional zgjedhor sot zbatohet në Holandë, Portugali, Spanjë, Zvicër, Austri, Danimarkë, Norvegji, Belgjikë, Luksemburg, Islandë dhe vende të tjera.

Modeli zgjedhor i përzier është kombinimi i modelit zgjedhor me shumicë dhe proporcional në variantin e ndryshme. Për herë të parë do të zbatohet në mesin e viteve të pesëdhjeta në shek. XX në Gjermani gjatë zgjedhjes së Bundestagut, me çka gjysma e deputetëve zgjidhen me sistemin e shumicës zgjedhore në variantin e shumicës relative, ndërsa gjysma sipas reprezentacionit proporcional. Modeli zgjedhor i përzier zbatohet edhe në Itali, si edhe në vendet postkomuniste.

Në Republikën e Maqedonisë, në zgjedhjet e treta parlamentare në vitin 1998, u zbatua, gjithashtu modeli zgjedhor i përzier në relacion: 85 deputet sipas modelit zgjedhor të përzier dhe 35 sipas atij proporcional.

Në mesin e shek. XIX deri sot zgjatë polemika për përparësitë dhe mangësitë e modelit të përzier dhe proporcional.

Në teorinë dhe praktikën zgjedhore theksohen përparësitë e modelit zgjedhor të shumicës : I rëndomtë dhe i kuptueshëm për qytetarin e rëndomt; për shkak të votimit në njësitë e vogla gjedhore, zgjedhësit i njohin kandidatët; i zbut kundërthëniet politike dhe i marginalizon partitë politike raadikale; nxit formimin e qeverisë stabile, efikase dhe përgjegjëse ndaj të cilës qëndron opozita homogjene e fuqishme; kontaktet në mes zgjedhësve dhe të zgjedhurve janë direkte etj.

Në sistemin zgjedhor të shumicës, vërejtjet janë: së është jo i drejtë për atë se fituesit janë mbiprezantuar, ndërsa të fituarit, janë nënprezentues; që është në favor të partive politike të mëdha dhe mirë të organizuara, ndërsa në dëm të partive të vogla politike, që e nxit partikularizmin, që hap hapësirë për hartimin e njësisve zgjedhore; që hap hapësirë për manipulimin e parimit të barazisë së votës; zmadhon rrezikun e korupcionit dhe është i shtrenjë kur është në dy rrethe.

Përkrahësit e modelit zgjedhor proporcional thekësojnë :se është i drejtë për atë se mundëson përputhshmërinë e përqindjes së votave të fituara me mandatet e fituara; i stimulon interesat e përgjithshme dhe konsenzusin; nxit multipartizmin ; është fleksibil dhe senzibil për ndryshimeve politike; zgjedhjet kushtojnë më lirë, redukton korupcionin; e pamundëson gjeometrinë zgjedhore; është më adekuat për kyçe më të madhe të gruas në politikë.

Argumentet kundër tij janë: operacionet matematikore të komplikuar të llogaritjes dhe rreziku nga "arithmetika zgjedhore"; pamundësimin e ekzistimit të partive politike radikale; ekzistimin e qeverisë jostabile dhe joefikase për shkat të përbërjes heterogjene; laramaninë dhe opozitën e dobët dhe ngjashëm.

Kuptohet, vlerësimi i modelit zgjedhor nuk është problem teorik, por para së gjithash është edhe çështje praktike. Nuk ekziston model absolutisht zgjedhor absolut i mirë dhe i keq. Zgjedhja varet, nga ambienti socio-politik dhe kulturor i vendit konkret, për atë që parimet e njejta në kushte të ndryshme në mënyrë të ndryshme, funksionojnë dhe për atë argumenti "PRO" bëhet kontra dhe anasjelltas.

10. Për zgjedhjet rregullare

Zgjedhjet e rregullta janë ato që zhvillohen në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe me rregulla juridike dhe jojuridike. Rregullësia e zgjedhjeve është në funksion të shtetit juridik. Ajo është e lidhur më ngusht me : përcaktimin dhe vërtetimin e të drejtës zgjedhore; punën e organeve për zhvillimin e zgjedhjeve dhe mbrojtjen e subjekteve zgjedhore.

Listat zgjedhore janë publike, të vetme dhe të përherëshme në të cilat regjistrohen të gjithë qytetarët që kanë të drejtë zgjedhore. Në to shënohen

zyrtarisht (ex officio) qytetarët që janë në moshë madhore kanë status të shtetasve në RM dhe kanë aftësi pune.

Listat zgjedhore të përgatitura shpallen në vende publike përkatëse pas shpalljes së zgjedhjeve për shkak të njoftimit direkt të qytetarëve, gjegjësisht kontrollës publike dhe azhurimit në pajtim me ndryshimet.

11. Organet për zhvillimin e zgjedhjeve janë ato që kujdesen për zhvillimin e procesit normal zgjedhor, si dhe rregullinë e zgjedhjeve. Bëhet fjalë për komisione të pavarura dhe individuale dhe këshilla zgjedhore që formohen në nivele të ndryshme. Është e zakonshme të ato të ketë përfaqësues nga organet shtetërore, partitë politike dhe qytetarët. Organ më i rëndisishëm për zhvillimin e zgjedhjeve është Komisioni zgjedhor shtetëror (qëndror) me kompetenca në tërë territorin shtetëror.

12. Mbrojtja e të drejtave të subjekteve zgjedhore zhvillohet nëpërmjet :

- a) organet zgjedhore;
- b) gjyqeve;
- c) Kuvendit.

Shkeljet dhe jorregulësit mund të kryhen nga qytetarët, anëtarët e organeve zgjedhore të cilët i zhvillojnë zgjedhjet, si dhe nëpunësit shtetërorë. Bëhet fjalë për vepra ndëshkuese për të cilat janë paraparë sanksione.

Subjektet zgjedhore kanë të drejtë ankese kundër vendimeve të këshillave zgjedhore për të cilat në shkallë të parë vendos Komisioni zgjedhor i njësisë zgjedhore, ndërsa për ankesat e njëjta vendos komisioni zgjedhor në shkallë të dytë. Kuptohet, këtij vendimi të komisionit mund t'i ankohen edhe para Gjyqit Suprem.

Në disa vende, përveç gjyqit të rregullt për konfliktet zgjedhore vendos edhe Gjyqi Kushtetues.

Rregullia e zgjedhjeve vendoset edhe nëpërmes të verifikimit të mandateve të kandidatëve nga ana e Kuvendit, pas kryerjes së zgjedhjeve.